

Vendim

i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "MSE" SHPK

Sot, më 22.11.2022, në selinë e shoqërisë "MSE" SHPK me NUIS L82001005A u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të saj në praninë e Ortakëve të saj si më poshtë:

1. **ILDA TËRSHANA**, ortake me 1 (një) kuotë, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 80% në kapitalin bazë të shoqërisë;
2. **ARBËR LIÇAJ**, ortak me 1 (një) kuotë, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% në kapitalin bazë të shoqërisë;
3. **CAN KUTAY ORTEN**, ortak me 1 (një) kuotë, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% në kapitalin bazë të shoqërisë.

ME REND DITE:

1. Miratimin e shitjes së kuotës së zotëruar nga ortakja ILDA TËRSHANA në favor të Z.ARBËR TEQJA, i biri i Ermirit dhe Arianës, i datëlindjes 22.10.1985, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rruga Sami Frashëri, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi me nr. personal I51022034R.
2. Miratimin e pasojave të shitjes së kuotës, si rrjedhojë e së cilës, Shoqëria do të zotërohet nga tre ortakët e mëposhtëm:
 - a. Ortaku Z.ARBËR TEQJA, i cili bëhet zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 4,693,600, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 80% në kapitalin bazë të Shoqërisë;
 - b. Ortaku ARBËR LIÇAJ, i cili mbetet zotëruar 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 586,700, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% në kapitalin bazë të Shoqërisë;
 - c. Ortaku CAN KUTAY ORTEN, i cili mbetet zotëruar 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 586,700, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% në kapitalin bazë të Shoqërisë
3. Shkarkimin e administratores të shoqërisë Znj.Dora Dibra nga ky pozicion, me efekt të menjëhershëm nga data e regjistrimit të këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

4. Emërimin e Znj.BESA VEZELAJ, lindur në Tiranë, më 03.12.1981 e banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. personal I16203031C, në cilësinë e administratores së shoqërisë "MSE" SHPK, për një afat 3 (tre) vjeçar me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
5. Autorizimin e Znj.BESA VEZELAJ me tagra të plota dhe të pakufizuara për regjistruar Kontratën për Shitjen e Kuotës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe për të kryer çdo aplikim e për të nënshkruar çdo dokument të nevojshëm me qëllim realizimin e sa miratuar në pikat 1 deri në 3 më sipër.

Bazuar në nenet 81 dhe 83/2 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), si dhe në Statutin e shoqërisë, pasi ortakët e shoqërisë

KONSTATUAN SE:

Bazuar në nenin 83/2 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), ortakët e shoqërisë, të pranishëm në mbledhje, deklarojnë se pavarësisht parregullsive eventuale në procedurën e thirrjes së kësaj, janë dakord që mbledhja të zhvillohet e të shqyrtojnë rendin e ditës, duke marrë vendime të vlefshme, pa asnjë pretendim apo kundërshtim në lidhje me to.

Ortakja ILDA TËRSHANA nuk është më e interesuar të jetë pjesë e strukturës së ortakëve të shoqërisë. Për këtë arsye, ajo ka vendosur të shesë kuotën e saj në favor të Z.ARBËR TEQJA.

Duke qenë se shitblerja e kuotës është në vullnetin diskrecionar të ortakëve, si dhe meqenëse ortakët ARBËR LIÇAJ dhe CAN KUTAY ORTEN nuk dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotën e zotëruar nga ortakja ILDA TËRSHANA, kjo Asamble vlerëson se vullneti i saj për të shitur kuotën në favor të Z.ARBËR TEQJA duhet të respektohet.

Më tej, administratorja DORA DIBRA ka paraqitur dorëheqjen nga pozicion dhe kjo Asamble vlerëson se dorëheqja e saj duhet të pranohet. Për rrjedhojë, shoqërisë i nevojitet një administrator i ri, pozicioni i cili vlerësojmë se mund të plotësohet nga kandidatura e Znj.BESA VEZELAJ.

Duke qenë se sa më sipër është në përputhje me interesat e shoqërisë "MSE" SHPK dhe parashikimet ligjore në fuqi, Ortakët e kësaj shoqërie, pas diskutimit të rendit të ditës, unanimisht

VENDOSËN:

1. Miratimin e shitjes së kuotës së zotëruar nga ortakja ILDA TËRSHANA në favor të Z.ARBËR TEQJA, i biri i Ermirit dhe Arianës, i datëlindjes 22.10.1985, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rruga Sami Frashëri, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi me nr. personal I51022034R.


2. Miratimin e pasojave të shitjes së kuotës, si rrjedhojë e së cilës, Shoqëria do të zotërohet nga tre ortakët e mëposhtëm:
- a. Ortaku Z.ARBËR TEQJA, i cili bëhet zotëruar 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 4,693,600, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 80% në kapitalin bazë të Shoqërisë;
 - b. Ortaku ARBËR LIÇAJ, i cili mbetet zotëruar 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 586,700, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% në kapitalin bazë të Shoqërisë;
 - c. Ortaku CAN KUTAY ORTEN, i cili mbetet zotëruar 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 586,700, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% në kapitalin bazë të Shoqërisë
3. Shkarkimin e administratores të shoqërisë Znj.DORA DIBRA nga ky pozicion, me efekt të menjëhershëm nga data e regjistrimit të këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
4. Emërimin e Znj.BESA VEZELAJ, lindur në Tiranë, më 03.12.1981 e banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. personal I16203031C, në cilësinë e administratores së shoqërisë "MSE" SHPK, për një afat 3 (tre) vjeçar me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
5. Autorizimin e Znj.Besa Vezelaj me tagra të plota dhe të pakufizuara për regjistruar Kontratën për Shitjen e Kuotës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe për të kryer çdo aplikim e për të nënshkruar çdo dokument të nevojshëm me qëllim realizimin e sa miratuar në pikat 1 deri në 3 më sipër.

ORTAKËT:

ILDA TËRSHANA

ARBËR LIÇAJ

CAN KUTAY ORTEN

Ilda Tërshana


Arbër Liçaj


Can Kutay Orten


KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Lidhur në Tiranë, sot, më 22.11.2022, ndërmjet palëve të mëposhtme:

SHITËSJA:

Ilda Tërshana, e bija e Sakip-it, shtetase shqiptare, lindur në Kavajë më 19.06.1982 e banuese në Tiranë, në adresën: Rr "Sami Frashëri", Kompleksi "TIT", G 3/1, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal I25619061W, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar (më tej referuar si "Shitësja").

BLERËSI:

Arbër Teqja, i biri i Ermirit dhe Arianës, i datëlindjes 22.10.1985, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rruga Sami Frashëri, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi me nr. personal I51022034R (më tej referuar si "Blerësi").

DHËNËS PËLQIMI:

1. Arbër Liçaj, i biri i Bilal-it, shtetas shqiptar, lindur në Fier, më 03.05.1985 dhe banues në Tiranë, në adresën: near Kopshti Zoologjik shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal I50503079J, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar;

2. Can Kutay Orten, i biri i Ali-ut, shtetas turk, lindur në Sungurlij, Turqi, më 28.09.1980 dhe banues në Tiranë, i identifikuar me pasaportën me nr.personal 41068884942, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

3. Z. INDRIT TËRSHANA i biri i Nehat dhe Vjollca lindur në Kavajë, Durrës më 23.12.1977 banues në Tiranë, Rr "Sami Frashëri", Kompleksi "TIT", G 3/1 i identifikuar me Pasaportën Biometrike me nr.BF9450127 dhe Nr.personal #H71223045V#, aktualisht përdorues i telefonit 00355682009008.—

SHARE PURCHASE CONTRACT

Entered into in Tirana, today, on 22.11.2022, between the following parties:

SELLER:

Ilda Tërshana, daughter of Sakip, Albanian citizenship, born in Kavaja, Albania, on 19.06.1982 and residing in Tirana, at the address: Rr "Sami Frashëri", Complex "TIT", G 3/1, identified by ID with personal no. I25619061W, adult, enjoying full legal capacity to act (hereinafter referred to as "Seller").

PURCHASER:

Arbër Teqja, son of Ermir and Ariana, born on 22.10.1985, born in Tirana and resident at the address: Rruga Sami Frashëri, Tirana, adult with full legal capacity to act, identified by identity card with personal: I51022034R (hereinafter referred to as "Purchaser").

CONSENTERS:

1. Arbër Liçaj, son of Bilal, Albanian citizenship, born in Fier, Albania, on 03.05.1985 and residing in Tirana, at the address: near Kopshti Zoologjik identified by ID with personal no. I50503079J, adult, enjoying full legal capacity to act.

2. Can Kutay Orten, son of Ali, Turkish citizenship, born in Sungurlij, Turkey, on 28.09.1980 and residing in Tirana, identified by passport with personal no. 41068884942, adult, enjoying full legal capacity to act.

3. Mr. INDRIT TËRSHANA the son of Nehat and Vjollca born in Kavaja, Durrës on 23.12.1977 resident in Tirana, Rr "Sami Frashëri", Complex "TIT", G 3/1 identified with Biometric Passport no. BF9450127 and Nr. personal # H71223045V #, currently telephone user 00355682009008.—

(hereinafter, separately referred to as the "Party" and jointly as "Parties")

(më tej referuar veç e veç si "Pala" dhe së bashku si "Palët")

BAZA LIGJORE:

Nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73-75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

DEKLARIME PARAPRAKE

1. Shitësja dhe dhënësit e pëlqimit janë ortakë në shoqërinë "MSE" SHPK, regjistruar pranë QKB me NUIS L82001005A, me seli në Tiranë, në adresën: Rruga Diga e Liqenit, nr. pasurie 8/312, vol.25, fq.40, zona kadastrale 8270, me kapital bazë prej 5,867,000 lekë (më tej referuar si "Shoqëria"), kapital i cili ndahet në tre kuota, përkatësisht:
 - 1.1. 1 (një) kuotë e zotëruar nga shitësja Ilda Tërshana, me vlerë nominale ALL 4,693,600 (katër milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind lekë), e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 80% (tetëdhjetë përqind) në kapitalin bazë të Shoqërisë;
 - 1.2. 1 (një) kuotë e zotëruar nga Dhënësi i Pëlqimit Arbër Liçaj, me vlerë nominale ALL 586,700 (pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind lekë), e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% (dhjetë përqind) në kapitalin bazë të Shoqërisë;
 - 1.3. 1 (një) kuotë e zotëruar nga Dhënësi i Pëlqimit Can Kutay Orten, me vlerë nominale ALL 586,700 (pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind lekë), e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% (dhjetë përqind) në kapitalin bazë të Shoqërisë
2. Shitësja kërkon të shesë Kuotën e zotëruar prej saj në Shoqëri dhe Blerësi është i interesuar ta blejë atë.
3. Bashkëortakët e Shitëses (dhënësit i pëlqimit Arbër Liçaj dhe Can Kutay Orten) dhe Z. Indrit Tërshana, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të

LEGAL FRAMEWORK:

Articles 705 *et seq.* of the Civil Code, as amended, as well as articles 73-75 of the law No. 9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and commercial companies", as amended.

PRELIMINARY REMARKS

1. The Seller and the Consenters are share-holders in "MSE" SHPK, registered at the National Business Center with NUIS L82001005A, having its legal seat in Tirana, Albania, at the address: "Diga e Liqenit" Street, property no. 8/312, vol. 25, pg. 40, cadastral area 8270, with a share capital of ALL 5,867,000 (*hereinafter referred to as "the Company"*), which is divided into three shares, respectively:
 - 1.1. 1 (one) share owned by the Seller Ilda Tërshana, with a nominal value of ALL 4,693,600 (four million six hundred and ninety-three thousand and six hundred Albanian lek), which gives her the right to participate with 80% (eighty percent) in the share capital of the Company;
 - 1.2. 1 (one) share owned by the Consenter Arbër Liçaj, with a nominal value of ALL 586,700 (five hundred eighty six thousand seven hundred Albanian lek), which gives him the right to participate with 10% (ten percent) in the share capital of the Company;
 - 1.3. 1 (one) share owned by the Consenter Can Kutay Orten, with a nominal value of ALL 586,700 (five hundred eighty six thousand seven hundred Albanian lek), which gives him the right to participate with 10% (ten percent) in the share capital of the Company.
2. The Seller wants to sell the Share owned by her in the Company and the Purchaser is interested in buying it.
3. The co-shareholders of the Seller (the Consenters Arbër Liçaj and Can Kutay Orten) and Mr. Indrit Tërshana with their full, free and unviced will, jointly

pacënuar, së bashku dhe veç e veç, japin pëlqimin për shitjen e Kuotës së zotëruar nga Shitësja dhe për të gjitha pasojat juridike si rrjedhojë e nënshkrimit të kësaj Kontrate, duke hequr dorë dhe deklaruar se nuk dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotën objekt shitjeje.

Për këto arsye, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacënuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë për Shitjen e Kuotës që Shitësja zotëron në shoqërinë "MSE" SHPK (më tej referuar si "Kontrata"), me kushte si më poshtë vijon:

NENI 1

Objekti

1.1 Objekti i kësaj Kontrate është përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit mbi shitjen e 1 (një) kuote me vlerë nominale prej ALL 4,693,600 (katër milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind lekë) e cila përfaqëson 80% të kapitalit bazë të shoqërisë "MSE" SHPK (më tej referuar si "Kuota"), të zotëruar nga Shitësja në favor të Blerësit.

NENI 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

2.1 Çmimi i shitjes së Kuotës do të jetë në vlerën prej EUR 100,000 (njëqind mijë euro) dhe do të paguhet nga Blerësi në favor të Shitëses në valutën "euro" përpara ose brenda muajit qershor 2023 nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë bankare me të dhëna si më poshtë:

Titullari: Ilda Tërshana

Banka: RAIFFEISEN BANK

IBAN: AL2420211020000000009548721

SWIFT: SGSBALTX

2.2 Të gjitha pagesat lidhur me ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të mbarten nga Blerësi.

NENI 3

Kalimi i pronësisë mbi kuotën

3.1 Me nënshkrimin e kontratës, Blerësi bëhet pronar i 1 (një) kuote me vlerë nominale prej ALL

and separately, consent to the sale of the Share owned by the Seller and to all the legal consequences resulting from signing this Contract, waiving and declaring that they will not claim to exercise the right to preemption on the share subject to sale

For these reasons, the Parties with their full, free and unviced will, decide to enter into this Contract on the Sale of the Share that the Seller owns in the company "MSE" SHPK (hereinafter referred to as the "Contract"), to the terms as follows:

ARTICLE 1

Subject matter

1.1 The subject matter of this Contract is to set forth the terms, modalities and consequences of the transaction on the sale of 1 (one) share with a nominal value of ALL 4,693,600 (four million six hundred ninety three thousand six hundred Albanian lek) which represents 80% of the share capital of "MSE" SHPK (hereinafter referred to as "Share"), owned by the Seller in favor of the Purchaser.

ARTICLE 2

Purchase price and method of payment

2.1 The purchase price of the Share will be in the amount of EUR 100,000 (one hundred thousand euros) and will be paid by the Purchaser in favor of the Seller in the "EURO" currency before or within June 2023 via bank transfer to the bank account with details as follows:

Title Holder: Ilda Tërshana

Bank: RAIFFEISEN BANK

IBAN: AL2420211020000000009548721

SWIFT: SGSBALTX

2.2 All payments relating to the execution and registration of this Contract shall be borne by the Purchaser.

ARTICLE 3

Acquisition of ownership over the Share

3.1 Upon signing the Contract, the Purchaser becomes the owner of 1 (one) share with a nominal value

4,693,600 (katër milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind lekë), e cila përfaqëson 80% të kapitalit bazë të shoqërisë "MSE" SHPK.

3.2 Regjistrimi i Kontratës pranë institucioneve përgjegjëse (si për shembull: Qendra Kombëtare e Biznesit) do të ketë funksion deklarativ ndaj të tretëve dhe Blerësi fiton pronësinë mbi kuotën në momentin e përcaktuar në nenin 3.1 më sipër, pavarësisht momentit se kur kjo Kontratë regjistrohet dhe publikohet pranë institucioneve përgjegjëse.

NENI 4

Pasojat e shitjes së kuotës

4.1 Palët bien dakord se si pasojë e shitjes së kuotës, Blerësi do të bëhet pronar i 1 (një) kuote e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 80% në kapitalin bazë të shoqërisë, ndërsa Shitësja zhvishet nga pronësia mbi kuotën e sipërcituar.

4.2 Palët deklarojnë se janë në dijeni që pala shitëse nuk ka asnjë detyrim në lidhje me shoqërinë dhe palë të treta lidhur me aktivitetin e kësaj shoqërie, i cili daton përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate.

4.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësja deklaron dhe pranon se heq dorë nga e drejta për të përfituar dividendët e pagueshëm të krijuar nga vitet e mëparshme ushtrimore si dhe fitimi i pashpërndarë i krijuar nga shoqëria, deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Për të shmangur çdo dyshim, heqja dorë e Shitëses për të drejtat e përcaktuara në këtë paragraf bëhet në favor të Blerësit i cili me fitimin e titullit të pronësisë mbi kuotën e shitur nga Shitësi, bëhet titullar i së drejtës së dividendëve.

4.4 Me nënshkrimin e Kontratës, Shoqëria do të zotërohet nga tre ortakët e mëposhtëm:

4.4.1 Ortaku Arbër Teqja bëhet zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 4,693,600, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 80% në kapitalin bazë të Shoqërisë;

of ALL 4,693,600 (four million six hundred ninety-three thousand six hundred Albanian Lek), which represents 80% of the share capital of "MSE" SHPK.

3.2 Registration of the Contract at the responsible institutions (such as: the National Business Center) shall have a declarative function towards third parties and the Purchaser acquires ownership over the share at the moment specified in article 3.1 above, regardless of the moment when this Contract is registered and published at the responsible institutions.

ARTICLE 4

Consequences of the Share purchase

4.1 The Parties agree that as a result of the sale of the share, the Purchaser shall become the owner of 1 (one) share which gives him the right to participate with 80% in the share capital of the company, while the Seller loses ownership over the aforementioned share.

4.2 The parties declare that they are aware that the selling party has no obligation regarding the company and third parties related to the activity of this company, which dates before the signing of this Contract.

4.3 By signing this contract, the Seller states and agrees that it waives the right to benefit from the dividends payable generated from previous fiscal years as well as the undistributed profit generated by the company, until the date of signing this contract. To avoid any doubt, the relinquishment of the Seller for the rights defined in this paragraph is made in favor of the Buyer who, upon gaining the ownership title on the share sold by the Seller, becomes the holder of the right to dividends.

4.4 Upon signing this Contract, the Company will be owned by the following three shareholders:

4.4.1 The Shareholder Arbër Teqja becomes the owner of 1 (one) share with a nominal value of ALL 4,693,600,

4.4.2 Ortaku Arbër Liçaj mbetet zotërues 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 586,700, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% në kapitalin bazë të Shoqërisë;

4.4.3 Ortaku Can Kutay Orten mbetet zotërues 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 586,700, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 10% në kapitalin bazë të Shoqërisë.

NENI 5 Garancitë e Palëve

5.1 Shitësja garanton Blerësin se:

5.1.1 Zotëron 1 (një) kuotë në Shoqëri, me vlerë nominale ALL 4,693,600, e cila përfaqëson 80% të kapitalit të saj bazë. Kuota në tërësinë e saj nuk është subjekt sekuestrimi, ndalimi shitje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve; Kuota gjithashtu nuk është subjekt i ndonjë barre reale apo juridike.

5.1.2 Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik, me përjashtim të dhënësve të pëlqimit në këtë kontratë;

5.1.3 Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin e kësaj Kontrate; ndërsa pala blerëse sipas marrëveshjes merr përsipër regjistrimin e këtij akti pranë QKB.

5.1.4 Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, Statutin e Shoqërisë, marrëdhënie detyrimesh mes shoqërisë dhe të tretëve apo Shitëses dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;

which gives him the right to participate with 80% in the share capital of the Company;

4.4.2 The Shareholder Arbër Liçaj remains the owner of 1 (one) share with a nominal value of ALL 586,700, which gives him the right to participate with 10% in the share capital of the Company;

4.4.3 The Shareholder Can Kutay Orten remains the owner of 1 (one) share with a nominal value of ALL 586,700, which gives him the right to participate with 10% in the share capital of the Company.

ARTICLE 5 Warranties of the Parties

5.1 The Seller warrants to the Purchaser that:

5.1.1 She owns 1 (one) share in the Company, with a nominal value of ALL 4,693,600, which represents 80% of its share capital. The share in its entirety is not subject to sequestration, sales ban, bank mortgage, or any other means that ensures the performance of obligations; The Share is also not subjected to any real or legal encumbrance.


5.1.2 She has the right and full capacity to decide the sale of the Share and to execute this Contract according to its provisions, without the need for the prior consent or approval of any other physical or legal person, with the exception of the Consenters in this contract;

5.1.3 Has undertaken or will undertake all necessary legal actions for the authorization and execution of this Contract; while the purchasing party, according to the agreement, undertakes the registration of this act at the QKB.

5.1.4 The performance of this contract will not result in a situation of illegality or avoidance, related to the Contract itself, the Articles of Association of the Company, relationships of obligation between the company and third parties or the Seller and third parties, or with the legislation in force;

5.1.5 Asnjë person i tretë fizik ose juridik nuk ka të drejta mbi kuotën apo kapitalin e Shoqërisë. 5.2 Blerësi garanton Shitësen se: 5.2.1 Blerja e 1 kuote e cila përfaqëson 80% të kapitalit të bazë të Shoqërisë, e zotëruar nga Shitësja është në përputhje me vullnetin e tij; 5.2.2 Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik; 5.2.3 Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për regjistrimin e kësaj Kontrate; 5.2.4 Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, marrëdhënie detyrimesh mes Blerësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi; 5.2.5 Vlera monetare e përdorur për blerjen e kuotës sipas kontrate është krijuar si pasojë e veprimtarisë së ligjshme. 5.2.6 Blerësi nuk është subjekt i ndonjë procesi penal lidhur me veprimtarinë e tij. 5.3 Dhënësit e Pëlqimit, së bashku dhe veç e veç, garantojnë Shitësen dhe Blerësin se: 5.3.1 Janë dakord me shitjen e kuotës së zotëruar nga Shitësja në favor të Blerësit; 5.3.2 Heqin dorë nga ushtrimi i së drejtës së parablerjes mbi Kuotën; 5.3.3 Nuk kanë pretendime, tani apo në të ardhmen, lidhur me shitblerjen e Kuotës sipas kësaj Kontrate, apo të drejtat e pronësisë që Blerësi fiton mbi Kuotën. NENI 6 Konfidencialiteti 6.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negociim parakontraktor do të trajtohen në përputhje me	5.1.5 No third person, natural or legal, has rights over the share or the capital of the Company. 5.2 The Purchaser warrants to the Seller that: 5.2.1 The purchase of 1 share, which represents 80% of the share capital of the Company, owned by the Seller is in accordance with his will; 5.2.2 He has the right and full capacity to decide on the purchase of the Share and to execute this Contract according to its provisions, without the need for the prior consent or approval of any other natural or legal person; 5.2.3 He has undertaken or will undertake all necessary legal actions for the registration of this Contract. 5.2.4 The performance of this contract will not result in a situation of illegality or avoidance, related to the Contract itself, the Articles of Association of the Company, relationship of obligations between the company and third parties or the Purchaser and third parties, or with the legislation in force; 5.2.5 The monetary amount used for the purchase of the share as per this contract has been obtained as a result of lawful activity; 5.2.6 The Purchaser is not part of any criminal process relating to his activity. 5.3 The Consenters, jointly and separately, warrant to the Seller and the Purchaser that: 5.3.1 They agree with the sale of the share owned by the Seller in favor of the Purchaser; 5.3.2 They waive the exercise of their right to pre-emption over the share; 5.3.3 They have no claims, now or in the future, related to the sale of the Share under this Contract, or to the ownership rights that the Purchaser acquires over the Share. ARTICLE 6 Confidentiality
--	---

parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëniet tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate. 6.2 Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit në rast se: 6.2.1 Pala tjetër ka dhënë pëlqimin për transmetimin e të dhënave; 6.2.2 Transmetimi bëhet në kuadër të përbushjes së një detyrimi; 6.2.3 Transmetimi i bëhet një këshilltari të shoqërisë, i cili është subjekt i detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit (p.sh. Avokatit, ekspertit kontabël); 6.2.4 Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të Palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat; 6.2.5 Nevojitet për ndjekjen e interesave legjitimë të palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat; 6.2.6 Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjetër dhe ndodhen në domain-in publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë; 6.2.7 Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njohura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë. 6.3 Për të shmangur çdo dyshim: regjistrimi i kësaj Kontrate pranë institucioneve përkatëse përfshirë Qendrën Kombëtare të Biznesit nuk përbën shkelje të detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit.	6.1 The parties agree that this Contract and any pre-contractual negotiations will be treated in accordance with the principle of confidentiality and that they will not transmit any data or information related to each other's commercial, financial or legal relationships, and that they will not do any statement regarding the existence, object or provisions of this Contract. 6.2 The parties are exempted from the obligation to maintain confidentiality in the event that: 6.2.1 The other party has given consent for data transmission; 6.2.2 The transmission takes place within the framework of the fulfillment of an obligation; 6.2.3 The transmission is made to an adviser of the company, who is subject to the obligation of maintaining confidentiality (E.g. lawyer, accounting expert); 6.2.4 It is necessary for the performance of a legal duty of public interest or the exercise of a competence of the Party that transmits the information or of a third party to whom the data has been disseminated; 6.2.5 It is necessary to pursue the legitimate interests of the party that transmits the information or of a third party to whom the data has been disseminated; 6.2.6 These data have been made public by the other party and are in the public domain and/or are accessible by third parties; 6.2.7 These data have been made public or made known to the party transmitting the data from third parties. 6.3 To avoid any doubt: The registration of this Contract at the relevant institutions, including the National Business Center, does not constitute a violation of the obligation to maintain confidentiality.
NENI 7 Komunikimi ndërmjet palëve 7.1 Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore ose nëpërmjet e-	ARTICLE 7 Communication between the parties 7.1 All communications between the Parties, as well as the requests they have to each other, will performed



mail-it, në adresat dhe e-mail-et e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.

7.2 Në rast se personat dhe/ose adresat dhe/ose e-mail-et e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palën tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën dhe/ose e-mail-in.

7.3 Çdo komunikim ndërmjet palëve është konfidencial dhe nuk mund t'i transmetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë personave të tretë me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 6.2 i kësaj Kontrate.

NENI 8

Interpretimi i kontratës

8.1 Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

8.2 Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e më specifikisht, nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73-75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

NENI 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

in writing or via e-mail, at the addresses and e-mails specified by the parties in the part of their generalities.

7.2 In the event that the persons and/or addresses and/or e-mails above undergo changes, the Party that undergoes them has the obligation to notify the other party within 24 hours from the moment of the change. Otherwise, any communication to the previous address will be considered valid even though it may not have been received by the Party that has changed the contact person and/or address and/or e-mail.

7.3 Any communication between the parties is confidential and cannot be transmitted directly or indirectly to third parties, except for the cases provided by Article 6.2 of this Contract.

ARTICLE 8

Contract interpretation

8.1 The conditions set forth in this contract shall be interpreted without stopping at the literary meaning of the words, but rather, taking into account the true purpose of the parties, which has caused them to sign this contract. The terms of the contract shall be interpreted through one another, with each one bearing the meaning that emanates from the entirety of the act. In case of doubt, the contract or its terms are interpreted in the way in which they may be effective and not in a way in which they would have no effect.

8.2 The applicable law for the interpretation of this Contract will be the legislation in force in the Republic of Albania, and more specifically, articles 705 et seq. of the Civil Code (amended), as well as articles 73-75 of the law no. 9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and commercial companies" (amended).

ARTICLE 9

Dispute resolution

9.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.

9.2 Nëse zgjidhja nuk mund të arrihet, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

Forca madhore

10.1 Për qëllim të kësaj kontrate, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që nuk shkaktohet dhe është përtej kontrollit të arsyeshëm të një prej palëve të kësaj Kontrate, e cila shkakton që përmbushja të detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin ndër të tjera, epidemitë, pandemitë, gjendjet e fatkeqësisë natyrore, luftën, mosbindjen civile, stuhitë, përmbytjet ose grevat.

10.2 Në rastet e ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore, afatet e parashikuara në të këtë kontratë për ekzekutimin e detyrimeve mund të shtyhen nëse është e nevojshme për aq kohë sa zgjat Forca Madhore. Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës.

NENI 11

Të tjera

11.1 Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:

- 11.1.1 Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;
- 11.1.2 Ekstrakt nga regjistri tregtar i Blerësit;
- 11.1.3 Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë;
- 11.1.4 Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë, datë 22.11.2022;

9.1 Parties must try to amicably resolve all disputes that may arise between them regarding this Contract.

9.2 If a resolution cannot be reached, the Contract shall be subject to judicial examination and the Tirana District Court shall enjoy full jurisdiction on resolving the dispute.

ARTICLE 10

Force majeure

10.1 For the purpose of this contract, "Force Majeure" means an event that is not caused and is beyond the reasonable control of one of the parties to this Contract, which causes the fulfillment of the obligations of the party in this contract to become either impossible, or so impractical, for the fulfillment to be reasonably considered impossible given the circumstances. It includes among others, epidemics, pandemics, of natural disasters, war, civil disobedience, storms, floods or strikes.

10.2 In cases where conditions of Force Majeure exist, if necessary, the deadlines set forth in this contract for the performance of obligations may be extended for as long as the Force Majeure lasts. Insufficiency funds and/or the non-performance of a payment that ought to have been made according to this Contract do not constitute Force Majeure.


ARTICLE 11

Miscellaneous

11.1 Attached and an integral part of this Contract are:

- 11.1.1 Copy of identification documents of the signatory parties;
- 11.1.2 Purchaser's extract from the commercial register;
- 11.1.3 Company's extract from the commercial register;
- 11.1.4 Decision of the General Assembly of Shareholders of the Company, dated 22.11.2022;

11.2 Any amendment to this Contract is made with the mutual consent of the parties and will be valid only if made in writing.



11.2 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim. 11.3 Kjo kontratë përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) faqe dhe është hartuar në 6 (gjashtë) kopje origjinale në shqip dhe anglisht, nga një për secilën palë nënshkruese, një për tu arkivuar nga Shoqëria dhe një për tu regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. 11.4 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.	11.3 This contract consists of 11 (eleven) pages and is compiled in 6 (six) original copies in Albanian and English, one for each signatory party, one to be archived by the Company and one to be registered at the National Business Center. 11.4 This contract enters into force upon its signing.
--	---

SHITËSIA: / SELLER:

Ilida Tërshana
ILDA TËRSHANA

DHËNËS PËLQIMI: / CONSENSERS:

Arbër Liçaj
ARBËR LIÇAJ

Indrit Tërshana
INDRIT TËRSHANA

BLERËSI: / PURCHASER:

Arbër Teqja
ARBËR TEQJA

Can Kutay Orten
CAN KUTAY ORTEN